



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 09.07.2013
Nr.0203-910

PËR: Smajl Latifi, Kryetar i Komunës së Rahovecit
Xhemali Haxhimustafa, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Rahovecit

LËNDA: Kërkesë për rishqyrtimin e ligjshmërisë së Vendimit të Komunës së Rahovecit
01Nr.808 pranuar më datën 05.07.2013

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të ligjshmërisë së Vendimit 01Nr.808 për Themelimin e Këshillit për Fshatin Hoç e Madhe të Komunës së Rahovecit **KONSTATON** se:

- Vendimi është në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit Nr.04/L-62 për Fshatin Hoçë e Madhe, si dhe me nenin 51 pik 2 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale i cili ka përcaktuar se: Kuvendi i Komunës themelon komitete të tjera, për të cilat konsideron se janë të nevojshëm për kryerjen e përgjegjësive të tyre.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, duke u bazuar në nenin 82 pika 2 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale *kërkon* nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës së Rahovecit që të ndërmarrin veprime konkrete, që Vendimin 01Nr.808 për Themelimin e Këshillit për Fshatin Hoç e Madhe të harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivot të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 09.07.2013
Br.0203-910

Za: Smajl Latifi, Gradonačelnik Opštine Orahovac
Xhemali Haxhimustafa, Predsedavajući Skupštine Opštine Orahovac

PREDMET: Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti Odluke Skupštine Opštine
Orahovac 01Nr.808 primljene dana 05.07.2013

Poštovani

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu Br. 03/L-040, Dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja zakonitosti Odluke 01Nr.808 za osnivanje Saveta za selo Velika Hoča Opštine Orahovac, **KONSTATUJE:**

- Odluka je u suprotnosti sa članom 4 Zakona Br.04/L-62 za selo Velika Hoča, kao i član 51 tačka 2 Zakona Br.03/L-040 za Lokalnu samoupravu koji je odredio: Skupština Opštine osniva ostale odbore, za koje smatra da su potrebni za vršenje njihovih odgovornosti

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, na osnovu člana 82 tačka 2 Zakona o Lokalnoj samoupravi *traži od* Skupštine Opštine/Gradonačelnika Opštine Orahovac da preduzme konkretne mere da Odluku 01Nr.808 za osnivanje Saveta za selo Velika Hoča uskladi sa zakonskim dispozicijama na snazi, u roku od 30 dana od datuma prijema zahteva za ponovno razmatranje akta.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamnik premijera i Ministar MALS-a

Kopija: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Rukovodiocima Uprava MALS-a
Arhivi MALS-a



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal Ministarsvo Lokalne Samoprave / Administracije Ministry of Local Government Administration			
Date Data		05.07.2013	
Mbrojtja e dokumenteve		Prokur.	Shërb.
-III-		0204-90A	

Në bazë të nenit 4 të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, në pajtim me nenin 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr. 04/L-040 dhe nenit 5 të Statutit të Komunës së Rahovecit, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e vet të mbajtur më 28 shkurt 2013, nxjerr këtë

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KËSHILLIT PËR FSHATIN HOÇË E MADHE

Neni 1

Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e vet të mbajtur më 28 shkurt 2013 në pajtim me nenin 4 dhe 10 të Ligjit për fshatin Hoçë e Madhe, nxjerr vendim për themelimin e Këshillit për Hoçën e Madhe.

Neni 2

Me këtë vendim autorizohet Ekzekutivi i Komunës së Rahovecit që nëpërmjet ftesës publike në pajtim me legjislacionin në fuqi të organizojë zgjedhje në fshatin Hoçë e Madhe për zgjedhjen e përfaqësuesve të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Neni 3

Kuvendi i Komunës me këtë vendim e autorizon ekzekutivin e Komunës së Rahovecit, që me anë të shkresës të kërkoj nga Kisha ortodoks serbe emrin e përfaqësuesit të kësaj kisha për anëtar të Këshillit për Hoçën e Madhe.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Ekzekutivi i Komunës dhe kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Rahovecit.

Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi 8 ditë nga dita e aprovimit dhe do shpallet në ueb faqe Komunës.

01 Nr. 805
Rahovec, 28.02.2013

Kuvendi i Komunës së Rahovecit



Kryesuesi i Kuvendit
Hemali Haxhimustafa